



ISO = POLIFONIA

GUSHT 2006, NR. 5

Botimi i Këshillit të Muzikës Shqiptare dhe Seksionit Shqiptar të CIOFF-it
Realizuar në bashkëpunim me stafin e gazetës "Dita JUG"

Tradita shqiptare e vajit dhe vajtimit

Studim "E qara me bote-me ulërimë" dhe origjina e iso-polifonisë popullore shqiptare

Nga Prof. Dr. Vasil S. TOLE

Vetë koncepti i "të qarës" rrjedh prej vajit, këngëtimit të vajtorëve dhe vajtojcave. Të frymëzuara prej dhimbjes vajtorët apo vajtojcë krijojnë muzikën dhe vargjet më patetike të mundshme. Në mbështetje të arsytimit tona të mëpastajme, në këtë pikë, na duket se është shumë i rëndësishëm konstatimi i E. Koliqit se i vdekuri në fantazinë e saj të tronditur asht një gjasend që ndien dhe arsyeton: prandaj zen me përligjërue me të e i thotë e porosit një mijë gjana për vendësit e mbretënisë së përjetshme, tue i përcjellë ato fjalë me lot e me britma.

Efekti tragjik i konstatimit të dukurisë së vajtimit masiv shumëzërësh, nuk ka kaluar pa lënë gjurmë përsëri edhe tek mjaft studiues dhe udhëtarë që përshkonin viset tona në kohë dhe vise të ndryshme. Një ndër këto është edhe ajo që lidhet me vdekjen e Panit të Madh. Sipas Plutarikut, një anije njoftoi vdekjen e Panit pranë liqenit Pelod (liqenit të sotëm të Butrintit), dhe pas kësaj u dëgjuan vajtime në grup, sikur shumë qenie të vajtonin së bashku. Edhe Konica, ka tërhequr me kohë vëmendjen në lidhje me vlerat unike që paraqesin në radhë të parë ato gjëmë-kuisjet e vajtoreshve shqiptare në Jug të Shqipërisë etj. Sipas mendimit më të përhapur, "e qara": del nga shpirti, me fjalët më të menduara dhe që i drejtohet të vdekurit për ta ndikuar atë.

Pa dëgjo, vëllai im,
S'të kas as fare, as fis,
Po për hatër të perëndisë,
E për një çyçkë me bathe,
Edhë për një okë djathë,
Dy lot për tuj do t'i zbras

Në këtë rrjeshtim të vajit, futet edhe "e qara me bote", në të cilën ne gjejmë gjenezën e lindjes së iso-polifonisë popullore, e shpallur së fundi nga Unesco edhe si "Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit".

I. "E qara me bote" si mandata për kumtimin e vdekjes.

Së pari do t'i referohemi analizës së kësaj dukurie në muzikën iso-polifonike të Shqipërisë së Jugut, si një bërthamë ende arkaike në të cilën mund të identifikojmë lindjen dhe perceptimin e dukurisë së jashtëzakonshme muzikore të iso-polifonisë vokale, sepse: *vajtmet janë djepi ku përkunden këngët e lashta dhe ato të reja*. Sipas Prof. Cabejt, fjala *bote* ka kuptimin *shtamë*, pra enë që mbush ujë. Të dhënat materiale dëftojnë se kjo fjalë është një me *botë, dhe, baltë, deltinë* si dhe me *baltë shtamash*. Ai e nxjer si fjalë të toskërishtes në pjesën jugore edhe në formën *bot-i*. Sido që ta kapësh, apo në të gjitha rastet që ta interpretosh, "e qara me bote" është përsëri e lidhur, si me të qarën me shtama (pra me rrëke lotësh), ashtu dhe me të qarën për dheun, për tokën, pra si një vajtim masiv për tokën. Pa

vijon në faqen 2



Nis gara e albumeve të polifonisë

Konkurs Kombëtar për albumin më të mirë të iso-polifonisë për vitin 2006

Për herë të parë do të organizohet Konkursi Kombëtar për albumin më të mirë me këngë të interpretuara nga grupet e iso-polifonisë të regjistruar gjatë vitit 2006 nga shëpitë diskografike brenda dhe jashtë vendit.

Kjo iniciativë që ndërmerret nga Rrjeti Kombëtar i Shoqatave të Iso-Polifonisë dhe Këshilli i Muzikës Shqiptare, natyrisht nën inkurajimin e institucioneve përkatëse në qendër dhe në qarqe, pa dyshim që është një rast i mirë përq të gjithë grupet që hulumtojnë, interpretojnë dhe regjistrojnë muzikën polifonike.

Në tregun muzikor shqiptar, aktualisht gjen me qindra kasetat, videokasetat, disqe, CD, dhe DVD me regjistrime të grupeve të njohura polifonike nga gjithë trevat shqiptare të Iso-Polifonisë. Ndërkohë që janë me qindra orë programe televizive që transmetohen në mënyrë të përhershme nga stacionet radio-televizive kombëtare dhe lokale. Ky "bum" në tregun e muzikës është një nga kontributet më të çmuara që interpretuesit i bëjnë traditës më të lashtë muziko-

re dhe përbën një dëshmi me shumë për respektin që kanë shqiptarët ndaj vlerave të rralla të isopolifonisë, e cila për faktin se vitit të kaluar është shpallur nga UNESKO si "kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit" tashmë nuk u përket më vetëm shqiptarëve.

Gjithë kjo pasuri e muzikës tonë tradicionale, repertori i njohur i polifonisë, interpretimet dhe krijimet e reja dhe shumë vlera të tjera të polifonisë që qëndrojnë "fshehur" dhe presin të zbulohen, është e nevojshme dhe e domosdoshme që të evidentohen, studiohen dhe jo vetëm të regjistrohen e shitene të shohin dritën publikimit, por të kenë mundësinë e ballafaqimit

dhe të konkurimit.

Konkursi Kombëtar për albumin më të mirë të iso-polifonisë të regjistruar gjatë vitit 2006, do t'i shërbejë jo vetëm vlerësimit të iniciativave të vetë grupeve për hedhjen në qarkullimin e vlerave aktuale të interpretimeve polifonike tradicionale, por edhe qëllimit që këto vlera të paçmuara të kulturës sonë shpirtërore kombëtare të kenë një mundësinë e ballafaqimit me mendimin shkencor të specialistëve. Ky ballafaqim vlerash natyrisht që do të ketë ndikimin e vet jo vetëm në nxitjen e shpirtit të garës, por edhe të vetëkoregjimit të interpretimeve të reja për të ruaritur të pastër linjat e orgjinalitetit dhe veçorive inter-

pretative të polifonisë.

Ky konkurs do të jetë një veprimtari e përvitshme, por duke qënë se sivjet organizohet për herë të parë dhe për të mos përjashtuar nga gara vlerat e regjistrimeve të mëparshme, nga organizatorët do të pranohen edhe albume të regjistruara para vitit 2006.

Organizatorët e konkursit, Rrjeti Kombëtar i Shoqatave të Iso-Polifonisë dhe Këshilli i Muzikës Shqiptare ftojnë të gjithë grupet polifonike, shoqërite kulturore dhe shtëpitë diskografike që të dërgojnë nga tre kopje të albumeve të regjistruara gjatë vitit 2006 në adresën: Niko Mihali, Rrjeti i Shoqatave të Polifonisë, Përmet.

Në numrin e ardhshëm të gazetës "Iso-Polifonia" do të parashtrahet një platforme më e plotë e mënyrës së organizimit, kriteret e vlerësimit, përbërjen e jurisë së konkursit dhe nëzbyrëbë e organizimit të shpalljes së fituesit. Kjo është një iniciativë e re kulturore që synojnë të japin ndihmesë për mbrojtjen e kësaj vlerë unike shqiptare që tashmë është radhitur krahas kulturave të tjera botërore.


Përmeti 2006 Multikulturor
Datë 19 - 22 Korrik 2006
Botimi i Qendrës Ndërkombëtare të Organizimit të Festivalëve Folklorikë dhe Artit Tradicional
Realizuar në bashkëpunim me stafin e gazetës "Dita JUG"

Në Përmeti edicioni i pestë i festës kulturore Përmeti Multikulturor 2006

EDITORIAL
Multikultura traditë e re

Ylber ngjyrash, mozaik vlerash

SUPPLEMENT

STAFI I GAZETËS
ISO-POLIFONIA

"Iso polifonia-Albanian Folk Iso Polyphony"

"Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit"

"A Masterpiece of oral and intangible heritage of humanity"

Organ i përmuajshëm i Këshillit të Muzikës Shqiptare, anëtar i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës IMC/UNESCO dhe seksionit Shqiptar të CIOFF-it. Gazeta botohet në qytetin muze të Gjirokastrës, "Pasuri kulturore e njerëzimit" mbrojtur nga UNESCO.

KËSHILLI BOTUES

KRYETAR NDERI: Prof. Ramadan Sokoll
KRYETAR I KËSHILLIT BOTUES:

Prof. Dr. Vasil S. TOLE.

ANTARË:

Akademik Jorgo Bulo, Prof. Dr. Fatmir Hysli,
Prof. Agron Xhagolli, Prof. Spiro Shtuni (USA),
Dr. Eno Koço (Angli), Prof. As. Josif Minga,
Bardhyl Londo, Aleks Todhe.

DREJTOR: Niko Mihail.

KRYEREDAKTOR: Engjëll Serjani.

KOLEGJIMI I REDAKSISË:

Arian Avrazi, Ilir Dhuri, Lefter Cipa, Muhamet Tartari, Sejmen Gjokoll, Maksi Kulo, Thanas Dino, Shkëlqim Hajno, Shkëlqim Guçe.
Pregatiti materialet në anglisht: Gentiana Brahimli.

Art-Design: Klidi Proko.

Kontakt: Këshilli i Muzikës Shqiptare

e-mail: tole@isopolifonia.com

Mob: 0 68 21 55551

Seksioni shqiptar i Cioff-it:

E-mail: egjikassoc@albmail.com

Cel: 0 69 22 34986

Gazeta "Iso polifonia-Albanian Folk Iso Polyphony":

E-mail: ditajug@yahoo.com

Cel: 068 22 04502



Këshilli i Muzikës Shqiptare-KMSH është person juridik i regjistruar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë me nr. Akti 3074, me vendimin nr. 1784. K.M.SH-Albanian Music Council zyrtarisht njihet si Komiteti Nacional i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës (IMC)-UNESCO, në Shqipëri. (CIM/49.631).

Tradita shqiptare e vajit dhe vajtimit

Studim "E qara me bote-me ulërimë" dhe origjina e iso-polifonisë popullore shqiptare



Nga Prof. Dr.
Vasil S. TOLE

vijon nga faqja 1

asnjë lloj dyshimi, "e qara me bote" (e hasim edhe si "e qarë me vome", në Malëshovë, Përmet), shfaqet si një mbetje e praktikave shumë të vjetra rituale të ceremonialit të vdekjes, kjo e lidhur edhe me boti-n, pra me njeriun si mikropjesëz e botës, që lind nga toka dhe vdes po në tokë. Duke bërë fjalë për sosjen e stinës njerëzore të një personi të caktuar, (pra të një boti), me përcjelljen e tij në botën e përtejme, na bën përshtypje fakti se "e qara me bote" ruan në strukturimin e saj, si bërthamën, modusin isopolifonik të ndërtimit (pra strukturën e shumëzërështit të lidhur ngushtësisht me ison, këtë ngashërimin masiv të pjestarëve në të "qarën me bote"), por dhe se evidenton mjaft qartë veten si një dukuri që është përbërëse e një rituali të mirë strukturuar. Këtu, së bashku qëndrojnë si të barabarta: e folura-e ligjëruara me zë, e kënduara dhe lëvizja.

E shoqja:

Pilo zëmëra, ç'më le,
u nis guri në Varre
hume me gjithë kope.

Shoqet:

Ti shoqe si shumë the,
kështu s'qajënë nër ne,
po vure në derexhe.

Në këtë pikëpamje na duket se "e qara me bote" është pjesë e një minitragjedie popullore, e cila nuk luhet më në teatrot antike, por bash mu në mes të "teatrit-shtëpi", në të njëjtën skenë qindërdravjeçare të njeriut. Sipas popullit: kërcet dhoma atje kur e mer një të qarë me botë, ja bëjnë të gjitha i-i-i. I Kadare ka vënë re dhe ka evidentuar ngjashmëritë që ekzistojnë mes teatrit primitiv dhe "të qarit me ligje" në

Jug, por dhe sidomos kur flet për rolin e përbashkët që kanë si vajtojcat ashtu edhe korri antik si përgjigje e fjalëve të tyre në komentimin e tipareve të të vdekurit. Tek e qara në grup, dhe në formacionet e saj të përveçme si "e qara me bote" apo "e qara me ligje", gjejmë të sendërtuara edhe format e organizimit strukturor, të cilat më pas u implementuan dhe u bënë të përveçme në strukturën e tragjedive antike të Eskilit (në mënyrë të veçantë tek tragjeditë Lutëset, Agamemnoni, Koforet dhe Eumenidet), me korife, kor, dhe recitues, si formacione për dhënien dhe fillimin e ceremonialit kompleks të mandatës së vdekjes.

Në studimin e "Odisheja dhe Sirenat, grishje drejt viseve isopolifonike të Epirit", kemi tërhequr vëmendjen në lidhjen që ekziston mes vajtimit dhe praktikave të varimit me tuma tek ilirët dhe epiriotët. ku mendohet se duhet kërkuar edhe fillesa e poezisë së lashtë gojore. Një skemë e tillë, e mirë strukturuar, sigurisht që tregon nivelin e lartë artistik të perceptimit të jetës dhe të vdekjes nga banorët e atyre anëve. Që kjo gjë nuk ishte e zakonshme, për këtë flet edhe fakti se tek Homeri ("Iliada", kënga XXIII dhe tek "Odiseja" kënga XXIV), gjejmë të përshkruar mjeshhtërisht dukurinë e vajtimit masiv, që siç do të shohim më poshtë nuk është gjë tjetër veçse forma arkaike e "të qarës me bote". Dëshmi të prekshme të atij realiteti kemi edhe ndër gjetjet e arkeomuzikës shqiptare, në mënyrë të veçantë tek "Sirenat vajtoresh" pa vegla muzikore të Apolonisë, Sirenat e Durrësit, Antigonesë dhe Vlorës, të cilat janë dëshmi unikale të këtyre personazheve tragjike të këndimit, por dhe të veprim-it teatral isopolifonik. Krahas "Sirenavë vajtoresh", ekzistenca në folklorin muzikor iso polifonik e disa gjinive si. p.sh në këngën iso-polifonike me origjinë mitologjike apo edhe në "vallet rituale",

mund të provojë se isopolifonia ka qënë bashkëudhëtarja muzikore e përhershme e gjinisë. Në këtë tip kënge të bien në sy, si një shtresim i lashtë me prejardhje mitologjike, një varg thirrjesh që sjellin jehonën e praktikave ritualomagjike, të lashta. Si shembull mund të përmendim të tilla formula stereotipe të fillimit të këngëve: "Oj lia oj", / Vaj lia vaj/ Vaj duduk vaj! etj. Në Shqipëri varret e vjetra në përgjithësi kanë drejtimin lindje-perëndim dhe kjo sipas Tirtës, kjo ka lidhje me kultin e diellit. Mbështetur Lukianit, sjellim në vëmendje se në rastin e varimit greku e djeg të vdekurin, persiani e kall në dhe, indiani e mbulon me një tis të tejdukshëm, skiti e ha dhe egjiptiani e than.

II. Bota e përtejme dhe "e qara me bote" si ndërlihdhëse

Konceptimi i shqiptarit për botën në përgjithësi shfaqet si një unitet binar, pra: *jeta=dynja e sipërme* dhe *vdekja=dynja e poshtme*. I konstatuar edhe nga studiues të etnokulturës, ky raport binar i perceptimit të jetës dhe vdekjes nuk ka funksionuar asnjëherë i ndarë si me thukë. *T'i thras t'dekunt me m'dihmue* thuhet në vargjet e një vajtimi tradicional shqiptar, pasi tek shqiptarët ekziston besimi se i vdekuri nuk humbet, por thjesht ndërton jetë. Në Shqipërinë Jugore e hasim edhe në formën: *i qe sosur dita*. Atë Lovro Mihaçeviq në shënimet e tij të udhëtimit në Shqipëri në vitet 1883-1907, ka konstatuar se shqiptari vdekjen e pranon me seriozitet dhe gjakftohtësi, sikur nuk duhet të vdesë kurrë, por të bëjë një udhëtim nga një vend këtu në një vend tjetër atje. Kadareja mendon se bota e përtejme, hyrjet dhe daljet që andej të personazheve, vajtjet atje të bujtësve të gjallë, e kthimit që andej të të vdekurve e kështu me radhë... bota e amaneteve, e kumteve dhe lajmeve të dërguara me anë zogjsh, resh a qyqesh, nga trevat e vdekjes në ato të jetës ose e kundërta ishin diçka normale për psikën shqiptare

dhe krijimtarinë e tij poetike. Pra, i gjithë ceremoniali i vajtimit, duket se është lënda lidhëse me dy botëve që përmendëm më sipër. Nuk ka asnjë dyshim se "iso-polifonia", si prodhim tingullor i "të qarës me bote", ka lindur në një hallkë shumë të rëndësishme kohore, e cila për ne përfaqëson momentin që qëndron: mes vdekjes trupore mbi tokë dhe përcjelljes në botën e pasosun, në dhe. D.m.th konceptimi dhe lindja e iso-polifonisë ndërlihdhet ngushtë me këtë fill kohor shumë të rëndësishëm që është: koha midisëse *as jetë as vdekje*.

Sigurisht që ka një element të rëndësishëm për botën e nëndheshme, e cila nuk preket dhe që nuk e njeh diellin, që nuk ndriçon dot në ato anë. Pavarësisht se sipas Lukianit vajtimi për të vdekurit ndjek kudo të njëjtat ligje, ne nuk do të lëmë pa përmendur faktin se Lumi i Vdekjes-Akeronti, dhe Hadesi, mbreteria e Vdekjes lokalizohen vetëm si të tilla në rajonin e maleve të Sulit, ish Thesprotia, Camëria e sotme. Në shënimet e udhëtareve të ndryshëm, deri në prag të shek. XX, lumin Akeront, e gjejmë të përcaktuar edhe si Lumi i Zi ndërsa ende sot, pika e kufirit mes Shqipërisë dhe Greqisë në zonën e Camërisë mbart togfjalëshin kuptimplotë: Qafa e Botës! Në lidhje me fjalën tragjedia, në Vlorë, kemi përfaqesjen e fjalës në emrin e fshatit Tragjas. Gjithashtu, banorët e Bregut të Detit, në mënyrë të veçantë piluriotët, ende i thërrasin këmbëçjepër, që sigurisht që lidhen me Panin, kjo në pikëpamje të aftësive të tyre muzikore, tepër të veçanta. Të qarën-vajtimit e hasim si toponimi (si fshati Vajzë, Vajkal etj), por edhe në realitete mitologjike siç është rasti i Grabofçit, i cili njihet si një qenie mitologjike që vazhdimisht qan me zë. Sipas traditës popullore, Grabofçi përfytyrohej si një gjarpër i madh me dy kokë, i cili zbulonte vetëm njërën dhe me tjetrën qante sikur të ishte i dëshpëruar.

vijon Nr. e ardhshëm



Përmeti 2006 Multikulturor

Datë 19 - 22 Korrik 2006

Botimi i Qendrës Ndërkombëtare të Organizimit të Festivaleve Folklorike dhe Artit Tradicional Realizuar në bashkëpunim me stafin e gazetës "Dita JUG"

Në Përmet edicioni i pestë i festivalit ndërkombëtar Përmeti Multikulturor 2006

Ylber ngjyrash, mozaik vlerash



Për të pestin vit ka nisur në qytetin jugor të Përmetit festivalit ndërkombëtar Permeti Multikulturor 2006, një veprimtari e përvitshme që organizohet nga Seksionit Shqiptar të CIOFF që është pjesë e Qendrës Ndërkombëtare të Organizimit të Festivaleve Folklorike, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe bashkia e qytetit të Përmetit. Pas ceremonisë në qender të qytetit ku artistë popullorë të grupe folklorike nga Dropulli, Maqedonia, Delvina dhe Përmeti parakaluar të veshur me kostume popullore tradicionale. Të shoqëruar nga orkestrinat e sazeve popullore dhe mijëra banorë të Përmetit, artistët pjesëmarrës në ceremoninë e hapjes përshkuan disa nga rrugët e qyteti.

Në skenën e madhe të koncerteve të hapura para Monumentit të Partizanit të Panjohur, artistët e ardhur nga krahina dhe vende të ndryshme ballkanike u përshëndetën nga Drejtori i Festivalit

Niko Mihali, kryetari i qarkut Resul Llogo, përfaqësuesi i MTKRS shkrimtari i njohur me orgjinë nga Përmeti Bardhyl Londo dhe kryetari i bashkisë së Përmetit Petrit Bregasi.

Në natën e parë dhanë koncertet e tyre grupi i valleve popullore tradicionale greke të Dropullit, grupi polifonik i Delvinës, ansambli folklorik i shoqërisë kulturore artistike "Valët e Liqenit" Ladorishtit nga shqiptarët e Maqedonisë dhe grupi i sazeve të djemve të Këlcyrës të përgatitur nga prifti ortodoks At Ramanoi.

Gjatë koncertit të grupit të valleve popullore tradicionale greke të Dropullit, një gjetje brilante e bërë së fundi instrumentisti, valltari dhe këngëtar i talentuar i ansambli Dropulli Andon Tunj u interpretuan me finësë 14 valle tradicionale greke.

Ndërsa në shfaqjen e grupit të shqiptarëve nga Maqedonia spikaten Vallja Dollapçe, Valle me mo-

tive të Ladorishtit, këngët "Kur ma hidhje vallen" dhe "Ma jep një pikë ujë" kënduar nga Blerand Lena dhe Fatjona Elmazi.

Në koncertin e grupit polifonik të Delvinës bënte pjesë repertori më i mirë i këngëve të vjera tradicionale delvinote dhe dy këngë të albumit të tyre të fundit. Befasia e koncertit të ditës së parë të Përmetit Multikulturor ishte prezantimi për herë të parë i një orkestrine të sazeve tradicionale përmetare të formuar dhe përgatitur me pasion të veçantë nga prifti ortodoks At Ramanoi me disa fëmijë të talentuar nga qyteti i Këlcyrës. Etnomuzikologu i njohur Vasil Tole i entuziazmuar niveli i mirë artistik i interpretimit u shpreh mjaft optimist për të ardhmen e kësaj orkestrine të re të ngritur nga prifti ortodoks At Ramanoi.

Në ditën e parë të festivalit 2006" u organizua promovimi i librit mografik të autorit Dr. Sali Hidri kushtuar publicistit Stavro Thoma Frashëri.

Gjatë kësaj veprimtarie, kryetari i këshillit të qarkut të Gjirokastrës Resul Llogo dorëzoi familjarëve të atdhetarit Stavro Thoma Frashëri, titullin "Nder i Qarkut të Gjirokastrës".

Festivalit ndërkombëtar "Përmeti Multikulturor 2006" do të vazhdojë deri ditën e premtë. Gjatë këtyre ditëve veprimtaritë janë të shumta. Grupi i Romëve Korçë, grupi vllah i fshatit "Andon Poçi", grupi Dion i Selanikut, ansambli turk "Byrlyk" i Mitrovicës nga Kosova, grupet folklorike të Tepelehtës, Mallakstrës, Gjirokastrës, etj, do të prezantohen në skenë.

Në program përfshihen panairë promovime librash dhe botimesh me krijimtari letrare, simpoziumi "Diversiteti Kulturor dhe Integrimi", tryezat e debatit Isopolifonia, sazet e usta Laver Bariut, vizita turistike, panairi i verërave përmetare dhe Dita e Peshkimit me grep në lumin e Vjosës.

E.Serjani

EDITORIAL

Multikultura traditë e risi

Kur gjashtë vjet më parë menduam të bëheshim organizatorë të këtij festivali që ka hyrë në axhendat e festivaleve ndërkombëtare, për shkak të mungesës së përvojës, nuk e kishim shumë të qartë se ku do të arrinim. Kishim vetëm dëshirën e madhe që t'i linim qytetit tonë diçka të bukur e të veçantë, t'i gjallëronim një traditë të hershme që dikur kishte ekzistuar në një formë tjetër në ditët e majit, por sigurisht duke i dhënë përmasa kombëtare e më shumë. Për të arritur këtu nuk ka qenë e lehtë, ka patur dhe ka vështirësi, por me angazhim e vlerësim më të madh nga organet e pushteti vendor dhe biznesi vendas ia kemi dalë mbanë. Në fillim nisi si një festival i ngjashëm me të tjerët, por nga njeri edicion në tjetrin i dhamë një fytyrë të re, i veshëm emrin multikulturor, gjë që na lejon të sjellim materiale muzikore të gjinive të ndryshme, nga treva të ndryshme dhe në veçanti fokusuar minoritetet dhe etnitë që jetojnë në vendin tonë.

Nëse bëjmë një bilanc në këto pesë vjet, në festival kanë marrë pjesë 44 grupe me rreth 820 pjesëmarrës. Në këtë mënyrë i kemi bërë një shërbim shumë të mirë qytetit tonë pasi këta 820 vetë kanë qenë ata që kanë çuar fjalë shumë të mira për qytetin tonë. Ndër grupet më të suksesshëm përmendim grupin e Dropullit, Sotirës, Dervicanit, Jonianët e Sarandës, Ergjësia e Gjirokastrës, asambli Lunxhëria, grupet e Tepelehtës, të Ballshit, të Vlorës, asambli Besa të Kavajës, grupin e Romëve të Tiranës, Devollit, Korçës, grupet e Kolonjës, asambli Hasan Prishtina, Opoja dhe të Akademisë së Arteve të Prishtinës, asambli Birlik nga Mitrovica nga Kosova, grupet e Gostivarit, Strugës, Ladorishtit nga Maqedonia, grupet shumë të bukura të Konicës, Janinës, Korfuzit, grupin polifonik Dion të Selanikut e shumë të tjerë. Këngët dhe vallet e këtyre grupeve kanë përcjellë mesazhet e paqes, dashurisë, mes popujve, të kulturave të tyre si dëshmi e bashkëjetesës.

Janë me dhjetra studiues e profesorë nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Ministria e Kulturës, IKP Tiranë, por edhe nga universitete të rajonit si nga ai i Prishtinës, Selanikut, Athinës, Janinës, Lidz në Angli, etj. Nuk dua të harroj pjesëmarrjen shumë produktive me temat e tyre për diversitetin kulturor të Prof Dr Vasil Tole, Agron Xhangolli, Ramazan Bogdani, Sabah Sinani, akademiku Jorgo Bullo, Prof. Dr. Eno Koço, Prof. Vasil Nitsiakos nga Janina, Aleksandër Llambridhis nga Athina, Jani Price nga SHBA, studiuesi Kosta Loli që jeton në Janinë, Dilaver Kryeziu nga Prishtina, Kain Myrtyshi nga Struga, e shumë të tjerë.

Ditët e festivaleve janë shoqëruar me aktivitete të shumta si promovimet e librave. E veçanta tjetër përcillet përmes vlerave ekoturistike që janë bërë pjesë e tij, por ky festival duhet të pasurohet me gjetje të tjera sikundër se mund të jetë Dita e Verërave. Festivali hapi siparin duke i dhënë qytetit më shumë gjallëri. Ne u themi artistëve popullorë mirësevini në qytetin e këngëve, në qytetin e mjeshtrit të madh Laver Bariut, në qytetin e festivaleve...

Niko Mihali & Aleks Todhe
Drejtes dhe organizues te festivalit

Përshëndetje e kryetarit të bashkisë Petrit Bregasi

Mirësevini në qyteti e shumë kulturave

Festivali ndërkom-bëtar "Përmeti Multikulturor" këtë vit shënon edicionin e tij të pestë. Ai në mënyrë krejt të natyrshme ka hyrë dhe është bërë pjesë e jetës së qytetit tonë, e njerzve të tij artdashës e kulturëdashës. Ka gjallëruar jetën kulturore dhe ekonomike e turistike të qytetit tonë dhe gjithë ata artistë, studiues e miq të ardhur nga qytete e vende të ndryshme kanë çuar

në vendbanimet e tyre këto mesazhe dashurie e bashkëjetese mes popujve të rajonit tonë.

Me këtë rast më lejoni të falenderoj e të përshëndes gjithë ata këngëtarë, instrumentistë, valltarë, drejtuesit e grupeve, studiuesit nga vendi e bota që vijnë me dëshirë e kënaqësi në këtë veprimtari. Ata kanë për të gjetur në këtë qytet gjithmonë mikpritjen dhe dashurinë e njerzve të thjeshtë,

vlerësimin që ata i kanë bërë dhe i bëjnë trashëgimisë sonë kulturore.

Një falenderim të veçantë e kam edhe për organizatorët e kësaj veprimtarie të cilët bënë të mundur që në harkun kohor të 5 viteve të krijojnë për këtë qytet një identitet kulturor me përmasa ndërkombëtare që nga viti në vit do të pasurohet edhe më tej.


Bashkia e qytetit e ka për nder të jetë



mbështetëse dhe donatore e kësaj veprimtarie e premtoj se edhe në të

ardhmen ky kontribut do të jetë edhe më i dukshëm.

PROFIL



Artisti nga Mallakastra i "pashaportizuar" në Përmetin Multikulturor

Polifonisti Guri Rrokaj nga Arianitasi i Mallakastrës, është pa asnjë dyshim një nga artistët më të njohur në "universin" folklorik shqiptar, që për shkak se ka qënë i pranishëm pothuajse në të gjitha edicionet e veprimtarisë ndërkombëtare "Përmetin Multikulturor", mund të quhet pa frikë një qytetar "i pashaportizuar" në qytetin e Përmetit.

Ky interpretues dhe bartës i shkëlqyer i folklorit të trevës nga vjen, njihet si një nga pjesëmarrësit më aktivë në dhjetra veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare të natyrës folklorike. Guri Rrokaj është vlerësuar me çmime dhe trofe në disa nga FFK të Gjirokastrës, në Festivalin e Veglave të Muzikës Popullore, dhe në veprimtari të tjera folklorike.

Së bashku me grupin folklorik të Mallakastrës ai ka regjistruar një CD krejt të veçantë në Bretanjë të Francës, ku janë alternuar interpretime të 5 grupeve popullore me interpretues nga Franca, Spanja, Korsika, Mali dhe Shqipëria. Ky përfaqësues i shpirtit krijues të popullit kohët e fundit është shfaqur në opinionin artistik edhe si një autor librash monografish. Pak ditë më parë promovoi në qytetin antik të Bylisit librin e tij të dytë të titulluar "Mallakastra monografi".

Për këtë kontribut në ruajtjen dhe lëvrimin e folklorit, disa muaj më parë ai është shpallur "Nderi i Qarkut të Gjirokastrës".

Multikultura në poezinë e Bardhyl Londos dhe në vëllimin e tij "Shenjtor dhe djall"

Urat poetike të Londos

Nga Niko MIHALI

Jo rastësisht në njerën nga ditët e këtij aktiviteti multikulturor u mendua të organizohej një takim me poezinë e njerit prej poetëve më bashkëkohore e më të talentuar të letrave shqipe të kohëve të fundit. Për fatin tonë të mirë ai është një nga djemtë e këtij qyteti, pikërisht poeti Bardhyl Londo. Si poeti ashtu dhe redaktori apo ai që i përzgjodhi dhe përgatiti vëllimin me poezi të zgjedhura "Shenjtor dhe djall", poeti Visar Zhiti është mes nesh dhe padyshim prania e tyre i bën nder veprimtarisë sonë, andaj u themi me kënaqësi dhe dashuri: Mirëserdhët në Përmetin Multikulturor 2006.

Edhe pse prej gati tre dekada larguar nga Përmeti poeti Bardhyl Londo lindur dhe ritur me këngët e zhurmshme të Vjoses, mbetet i pranishëm jo vetëm në kujtimet e shokëve të fëminisë, por së pari tek poezia e tij që lexohet e ngacmon çdo moshë. Kur takohemi me poezinë e tij e themi me mburje edhe me krenari: ja ky është poeti ynë, poeti që ka qënë mësuesi ynë, poeti që e nje çdo rrugicë e breglumi. Një qytet që di e do të bashkëtojë mes një mozaiku kulturor, që do dhe "prodhon" poezi e poetë, di ta lexojë e ta kuptojë mirë poezinë. Londo nuk u bë poet atje në Tiranë, por lindi e u bë poet këtu, këtu shkroi lirikën e vëllimit e para. Pastaj si një udhëtar i mirë, ai mori diç-

ka përmetare për atje në qytetin e madh. Ai udhëtoi me atë diçka përmetare nëpër botë dhe ashtu si Odiseu, ai kërkon e kthehet në Itaken e tij. Por çfarë mund të jetë ajo që ai rrëmbeu vendlindjes? Poetika dhe filozofia poetike, profili multikulturor i Londos përmbledhet në vargun e tij proverbial *Vetëm Itaka mbetet*.

Studiuesit e kanë vendosur poezinë e Londos mes Naimit dhe Agollit. Po të lexosh krijimtarinë e tij poetike ndesh në udhëtarin që kudo që shkon mbetet njeri i lidhur pazgjidhmërisht me vendin e tij dhe vendlindjen.

Nga vëllimi i parë "Krisma dhe trëndafili" i botuar para 30 vjetësh që pason me vëllimet "Hapa në rrugë", "Emrin e ka dashuri", "Si ta qetësoj detin", "Vetëm Itaka", "Ditë njerëzore", "Kur perënditë ndaluan vetevrasjen", "Ekzodi i yjeve" e gjer tek vëllimi i fundit, "Shenjtor edhe djall", gjen me mijëra vargje që janë pjesë e jetës së një gjenerate e të disa brezave. Aty gjen heroin lirik që nuk ka premtuar asnjëherë pallate të kristalta, nuk ka premtuar qiellin e shtatë të lumturisë e as paqe biblike, por që ka ecur gjithë jetën dhe edhe pse nuk ka mbajtur armë gjithmonë ka qënë luftëtar, ne do të gjejmë poetin që veç vargjeve mundohet të ngrejë ura të lidhen brigjet dhe nëse nuk do ta shohim një ditë në vendin e



Pamje nga promovimi i librit të shkrimtarit Bardhyl Londo.

tij, mos u besoni fjalëve se na ka harruar, por besojni vërtet, është shndërruar në një Rozafë, atje ku Vjosa rreh me furi brigjet e vendlindjes... Krijimtaria letrare e Bardhyl Londos shtrihet në dekadat që përkohet me dy kohë e dy botë. Nëse në pjesën e parë të krijimtarisë poezia e tij është më e qetë dhe më e preleshme me nota simbolike e deri diku ezopike, në periudhën e dytë ai nuk kursen as satirën dhe sarkazmën për gjithë ata që shtetin e shokërinë e quajnë një çiflik të tyre dhe duan ta vjelin deri në qelizë.

Profili multikulturor i Bardhyl Londos do të ishte i paplotë nëse do të ndalemi vetëm tek poezitë e këtij vëllimi. Ka dhe një faqe tjetër që mbase pak e njo-

him, por që gjendet në parathënien e një vëllimi poetik të një shoku të tij të shkollës së mesme në Përmet, të mikut të fëminisë në vëllimin poetik të Doktor Rustem Kekos. Bardhi i ka zhveshur bluzën e bardhë doktorit të nderuar dhe ka prezantuar anën tjetër po aq humane atë të intelektualit poet me mallin e nostalgjinë që ka për vendlindjen sikur do të thotë që kjo tokë e kjo Itakë kaq e bekuar të bën poet edhe në moshë të thyer. Poezitë e këtij vëllimi janë përzgjedhur nga një poet tjetër po aq i talentuar i letrave shqipe Visar Zhiti. Ai ka bërë punë tepër të kujdeshme për të cilën duhet ta falenderojmë dhe nëse kemi parasysh krijimtarinë e tij, ai këtë rradhë nuk hedh një kafkë tek këmbët

e njerzve, por hedh një tufë me gurë të çmuar ku shkëlqejnë me qindra e qindra vargje që sjellin një mozaik ndjenjash, përjetimesh e përçojnë emociione tek të gjithë lexuesit. Në vëllimin e fundit tërheq vëmendjen poezia "Duke iu rrëfyer Jezu Krishtit" jo vetëm për formën poetike të shkruar në formën e kryqit, por edhe për mesazhin që përcjell. Një dialog i bukur me plot imazhe, aliteracione e asonanca poetike ku portreti i Jezusit jepet si sinonim i ndershmërisë së njeriut .. po mbi dërrasën e mjerë të kryqit të thatë, plaga jote kullonte pikë - pikë... gjak. Prandaj dilema e vëllimit të tij është e zgjidhur, një bashkëjetese me vrytytin, ndershmërinë, moralin. Ai vjen pranë nesh vetëm si shenjtor.

Minoritetit grek befason Përmetin me bërthamën e ansamblit të ardhshëm "Dropulli"



Tuni sjell një zinxhir brilant vallesh dropullite

Treva me folklor të pasur autentik e minoritetit etnik grek e Dropullit ka qënë vazhdimisht e përfaqësuar në katër edicionet e mëparshme të Përmetit Multikulturor, përfaqësimi në edicionin e këtij viti ka qënë i veçantë dhe mjaft dinjitoz. Art-dashësit përmetarë që kanë mirëpritur në vitet e mëparshme grupet folk-

lorike të fëmijëve të Derivicianit, grupin polifonik të grave të Sotirës, Llongos dhe Koshovicës, kësaj herë janë befasuar nga prezantimi i grupit mix me djem e vajza me pasion për vallet të tradicionale greke të Dropullit. Ky grup me fytyra të reja është ngritur së fundi nga folkloristi dhe bartësi i njohur i vlerave të folkut të minoritetit grek, instrumentisti, valltari dhe këngëtari i talentuar Andon Tunj. Për herë të parë, tek dashamirët e artit grek, që bashkjeton aq bukur me folkun shqiptar në këto treva, u rikthyen imazhet e dikurshme të "nuseve" si zana mali të Dropullit. Disa interpretues virtuoz e plot pasion për vallet si Edhoksia Tunj e bija e Andonit, Vasiloka Çavo, Theodhori Nasto, etj, sipas "usta Tunj" premtojnë shumë. Kjo është një meritë e padiskutueshme e të talentuarit Andon Tunj i cili është deklaruar se ky grup do të jetë bërthama e ringritjes së Ansambllit Artistik të Dropullit. Grupi i selektuar nga pjestarët e 8 kurseve të ngritura nga vetë Tunj në disa fshatra të komunave të minoritetit etnik grek në këto 4-5 muajt e fundit ka interpretuar me finesë një "zinxhir" prej 14

valle tradicionale greke që i përkasin disa zonave etnokoreografike në fshatrat e minoritetit etnik grek në Shqipëri dhe zonave të ndryshme folklorike në Greqi. Midis valle të interpretuara gjatë koncertit të grupit që përfaqësonte minoritetin grek në Shqipëri, publiku përmetar përcolli me duartrokitje, Vallen Dyshe të Dropullit, Vallen e Nuses. Pogonish-te, Zagoriço, Valle Treshe Kasaposerviko, Epirotiko, etj. "Grupi që përfaqëson minoritetin etnik grek në këtë veprimtari, është i përbërë nga djem dhe vajza të reja nga fshatra të ndryshme nga komunat e Dropullit të Poshtëm dhe Dropullit të Sipërm të cilët me dëshirën për të mbajtur të gjallë traditat e të parëve të tyre, 3-5 muaj më parë më kanë kërkuar që t'u mësoj vallet dhe të ngremë së bashku një ansambël artistik folklorik të modelit të dikurshëm të "Ansambllit Dropulli" që shkëlqeu dikur në të gjithë Shqipërinë dhe Greqinë, por që më pas u shua në vorbullën e tranzicionit si shumë vlera të kulturës e të diversitetit kulturor", tha udhëheqësi i grupit të dropullit Andon Tunj.

Engjell Serjani

Toskët nga Ladorishti i Strugës sjellin folkun e tyre si valët e buta të liqerit të kaltër Ngjyrat e Strugës mbi rrjedhën e Vjosës

Ylberet e Strugës mbi rrjedhën e Vjosës. Në rrugët e Përmetit u shfaqën të parët me veshjet e tyre tradicionale artistët e ardhur nga Struga. Më shumë se dyzet vajza dhe djem të kapur dorë për dorë nisën një valle në bulevadrin kryesor të qytetit që u përroll me dashuri dhe respekt nga banorët dhe të ardhurit në Përmetin Multikulturor. Ndërsa në shfaqjen e këtij grupi që përfaqësonte shqiptarët e Maqedonisë spikatën interpretimet e grupit vezullës të valleve në Vallja Dollapçe dhe Valle me motive të Ladorishtit, si dhe këngët popullore "Kur ma hidhje vallen" dhe "Ma jep

një pikë ujë" të kënduara plot kolorit nga Blerand Lena dhe Fatjona Elmazi. Pas shfaqjes udhë-heqësi i shoqërisë kulturore artistike "Valët e Liqenit" etnomuzikologu Shevdat Jonuzi tha se: "Ladorishti dhe 6 qendra të tjera banimi të vendosura pranë liqenit të Ohrit bëjnë pjesë në një zonë etno-kulturore që nga shqiptarët e Maqedonisë konsiderohet "toskë" pasi kanë prejardhje nga trevat shqiptare të Toskërisë. Në Ladorisht dhe disa fshatra përreth liqenit kemi për traditë etnografike veshje të ngjashme me ato të zonave jugore të Shqipërisë, ndërkohë që në traditën e folklorit muzikor

bën pjesë kënga polifonike me marrës, kthyes dhe iso", tha Jonuzi. Ansambli i Ladorishtit është themeluar në vitin 1949 dhe qysh në fillimet e tij artistike e ka shtrirë aktivitetin e tij jo vetëm në hapësirën brenda Maqedonisë por edhe në treva të tjera jashtë Maqedonisë si në Bullgarin, Turqin, Shqipërinë, Kosovën, etj. Kontaktin e parë me Përmetin organizatorët e tij e kanë patur vitin e kaluar në qytetin e Prishtinës dhe brenda një viti ansambli u bë pjesë e përhershme e Përmetit Multikulturor. Ansambli "Valët e liqenit", ka marrë çmimin e parë në festivalin Ndërkombëtar të Shk-



upit, është pjestar i përhershëm i festivalit të IsoPolifonisë në Vlorë. Nga pikëpamja interpretative e veçantë e këtij grupi është se në ndryshim nga grupet e tjera në Maqedoni dhe Kosovë, isopolifonia është pjesë e pandarë etj. Shoqëria kulturore me të njëjtin emër numëron sot një numër të madh anëtarësh.

Gentiana Brahimi

Një libër dhe një titull nderi për figurën e spikatorit të etnosit shqiptar Stavro Thoma Frashëri




Veprimtaria që hapi siparin e festivalit "Përmeti Multikulturor" i është kushtuar njeriut prej figurave më të spikatura të publicistikës në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, Stavro Thoma Frashërit. Ky intelektual i kompeltuar, hulumtues i etnosit shqiptar, por jo shumë fatlum në jetë, përcolli nga origjina e tij e kësaj treve dashurinë, humanizmin dhe iluminizmin e paraardhësve të tij. Kontributi, puna dhe jeta e tij vijonë në faqet e librit "Hulumtuesi i bukurisë shqiptare", me autor Dr. Sali Hidri, promovimi i të cilit u bë në ditën e parë të festivalit. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë përfaqësues të minitrisë së kulturës, të bashkisë Përmet, redaktori i librit Prof. Dr. Agron Xhagolli, përfaqësues të Akademisë së Shkencave dhe dy djemtë e tij Edgar e Ilia Frashëri. Niko Mihali organizator i festivalit ka folur për jetën e Stavro Frashërit, më pas e kanë marrë fjalën autori i librit, redaktori, studiues të ndryshëm, të ftuar si dhe djemtë e tij. Të pranishmit vlerësuan jo vetëm figurën e Stavro Frashërit, por edhe botimin e arrirë nga Dr. Sali Hidri që ka bërë një punë të gjatë kërkimore, e studimore për të nxjerrë në pah vlerat e këtij njeriu. Kryetari i Këshillit të Qarkut Resul Llogo e ka nderuar Stavro Thoma Frashërin me titullin e lartë "Nderi i Qarkut". Ky titull iu është dorëzuar djemëve të tij që kanë shprehur falenderime për organizatorët e aktivitetit, për autorin e librit si dhe për vlerësimin e dhënë nga Këshilli i Qarku Gjirokastrë.

Hulumtuesi i bukurisë shqiptare

Kush ishte Stavro Thoma Frashëri

Një emer i njohur jo pak në gjysmën e parë të shekullit XX, në Shqipëri, por edhe në vende të tjera. Ai u harrua dhe u syrgjynos në gjysmën tjetër të shekullit, për të ardhur tani si simbol i intelektualit të virtytshëm nga jeta e të cilit kemi ç'të mësojmë.

Jo më kot autori i këtij studimi e ka emërtuar librin e tij me titull e bukur e shumë sinjifikativ "Hulumtuesi i bukurisë shqiptare". Stavro Frashëri ka qënë e mbetet model i njeriut të palodhur, sa publicist dhe etnograf që u përpoq gjatë gjithë jetës së tij për të qënë i dobishëm për vendin e shoqërinë shqiptare, duke zgjedhur një rrugë të vështirë dhe fisnike atë të trashëgimisë kulturore. Në faqet e këtij libri ai vjen si një figurë poliedrike me kapacitet të lartë intelektual e shkencor, nga bangat e shkollës së mesme, në punën si mësues, vëzhgues i hollë i realitetit shqiptar, një sy i vëmendshëm për çdo gjë të bukur të trashëgimisë sonë. Një njeriu që vuajti në qelitë e burgjeve komuniste, një metodist i vëmendshëm për ata që duan të merren me studimin e folklorit shqiptar. Stavro Frashëri rradhitet në plejadën e atyre njerëzve që hodhën gurët e parë të folkloristikës shqiptare. Ai thotë autori i librit -nuk ishte studjues i studiove të mbyllura, por një intelektual i palodhur në përzgjedhjen e materialit burimor atje në truallin e lindjes. Ai në profesion ishte inxhinier elektrik me dip-lomë të shkëlqyer nga univeriteti i Selanikut, një ndër inxhinjerët e parë elektrikë të Shqipërisë, por pasioni dhe dashuria që kishte për artin popullor, e radhit atë një ndër ata intelektualë që të frymëzojnë e inspirojnë.



Programi i veprimtarive "Përmeti Multikulturor 2006"

E mërkurë, datë 19 Korrik:

Ora 18:00 – 19:00 *Prezantim i librit:* Hulumtuesi i Bukurisë Shqiptare i autorit Dr. Sali Hidri, kushtuar folkloristit dhe publicistit me orgjins permetare Stavro Thoma Frashëri. I jepet titulli Nder i Qarkut (pas vdekjes). Bar "Familjari" (A.Kristani).

Ora 20:00 Ceremonia e çeljes së Festivalit Përmeti MK 2006. Sheshi i qytetit

Ora 20:15 Koncert i grupeve Ansambli "Dropulli", Grupi "Jonianët" Sarandë dhe grupi i Romëve Korçë.

Ora 22 :00 Darka për grupet pjesmarrëse dhe të ftuarit nga rrethet. Bar "Familjari"

E enjte, datë 20 Korrik:

ora 07-09 Vizitë në Kishën e Leusës Monument Kulture, të ftuar, studiues, qytetarë, etj. Nisja nga qendra e qytetit

Ora 09:00 – 10:00 1 – *Panairi i librit Përmeti Multikulturor 2006*

2 – *Prezantime librash të autorëve:* Dr. Rustem Keko & Petraq Ballabani nga sh.b. "ARGETA" Tiranë.

3 – Ekspozita e artit iranian në fushën e botimeve. Ish-shtëpia e oficerëve

Ora 11:00 – 13:00 Vizitë në Grykën e Këlcyrës dhe Kishën e Kosinës. Nga qendra e qytetit

Ora 18:00 – 19:00 Ekspozitë e botimeve në fushën e Polifonisë. Tek Dani.

Ora 20:00 Koncert i grupeve: Ladorishtit Maqedoni, Tepelenë, Ballsh dhe grupi vllah "Andon Poçi". Sheshi i qytetit

Ora 22:00 – 23:00 Tavolinë e rrumbullakët: "Isopolifonia, sazet e usta Laver Bariut dhe kontributi i tyre në vite". Studio e AOS Televizioni lokal.

E premte, datë 21 Korrik:

Ora 06:00 – 08:00 *Eko-Turizëm:* Dita e peshkimit me grep në Vjosë. Çmimet për peshkatarin më të mirë ndahen në mbrëmje nga Agjensia "Vjosa Travel". Sheshi qytetit

Ora 08:00 – 08:30 Vizitë në Gurin e Qytetit, Monument Kulture.

Ora 09:00 – 10:00 *Simpoziumi ndërkombëtar:* "Diversiteti Kulturor dhe Integrimi" me pjesmarrje të studiuesve nga hapësira shqiptare, Ballkanike, etj. Kisha e Shën Premtes, Përmet

Ora 10:30 *Mbledhje e Seksionit Shqiptar të CIOFF* Tek Dani

Ora 12:00 – 16:00 Vizitë në kanionet e Lingaricës dhe Ujrat Termalë të Bënjës. Nisja nga qendra

Ora 18:00 – 20:00 Diskutim e mendime: Kontributi në fushën e poezisë dhe krijimtaria e poetit përmetar Bardhyl Londo. Bar "Kivaldi"

Ora 20:00 -Koncert i grupeve: Dion të Selanikut, Asambli Turk. Byrlyk i Mitrovicës, Kosovë, etj.

-Mbyllja e festivalit Përmeti Multikulturor 2006. Sheshi i qytetit

Ora 22:00 Darka për grupet pjesmarrëse dhe të ftuarit.

E shtunë, datë 22 Korrik:

Ora 07:00 - 09:00 Përcjellja e grupeve pjesmarrës, miqve, të ftuarve, etj.. Në qendër të qytetit



ORGANIZATORËT

Seksioni Shqiptar i CIOFF-it, Përmet
Këshilli i Muzikës Shqiptare, anëtar i IMC/ UNESCO, Tiranë
Bashkia, Përmet
Shoqata Kulturore Artistike "Elena Gjika- Dora D'Istria", Përmet

Me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Fondacionit SOROS, Këshillit të Qarkut Gjirokastrë.

SPONSORË:

- Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Tiranë.
- Bashkinë Përmet,
- Fondacioni OSFA-Tiranë,
- Firma "Vjosa Travel", Tiranë,
- Sh.K. "Elena Gjika",
- Albania Online Internet,
- Banka Popullore, Tiranë
- Tirana Bank
- Këshilli i Qarkut, Gjirokastrë,
- Firma "Dola", Tiranë
- Firma "Kaleshi", Tiranë
- Firma "Ro-Gat-Security", Tiranë
- Gazeta "Dita JUG"



KOMITETI ORGANIZATIV:

- Usta Laver Bariu, President Nderi i Festivalit.
Z. Petrit Bregasi, Kryetari i Bashkisë, Përmet, President i Festivalit.
Z. Niko Mihali, Drejtor Ekzekutiv "Përmetit Multikulturor".
Z. Aleks Todhe, Përgjegjës i kulturës në Bashkinë Përmet, Koordinator.
Z. Ani Çulli, Drejtor i marketingut.
Z. Engjell Serjani, Kordinator me mediat.
Z. Arjan Todhe, fotograf.

KONTAKTONI ME:

Seksioni Shqiptar i CIOFF, pranë SH.K. "Elena GJIKKA-Dora D'Istria", Përmet
Tel/Fax: 00355 813 2426, Cel: 00355 69 22 34986,
e-mail: egjikassoc@albmail.com

Nr. i Llogarisë pranë RAIFFEISEN BANK, PERMET
Seksioni shqiptar i CIOFF-it, Raiffeisen Bank Branch Përmet,
Nr.0002627239(SWIFT Code SGSBASLTX Reuters SSAL SGSA)

27 Tetor - Kongresi i CIOFF-it në Bullgari

Nga data 27 tetor deri me 4 nëntor 2006 në Veliko- Torno do të zhvillohet Kongresi Botëror i radhës i Organizatës Botërore të CIOFF. Në këtë kongres do të marrin pjesë rreth 90 delegacione nga e gjithë bota. Kongresi do të diskutojë probleme që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore të vendeve të ndryshme të botës dhe mënyrën e propogandimit më mirë të tyre në veprimtaritë ndërkombëtare.



Seksionin Shqiptar i CIOFF, do të përfaqësohet në këtë kongres, pasi në të do të marrë pjesë delegacioni shqiptar i kryesuar nga Presidenti i këtij seksioni z. Niko Mihali dhe nga dy anetarë të tjerë. Veliko-Tornovo, vendi ku do të mbahet ky kongres është një qytet shumë i bukur në pjesën lindore të Bullgarisë dhe dallohet për një jetë të gjallë kulturore e artistike në rajon.



Kolektiviteti i Iso-s

Veçori e këngës polifonike është pikërisht të mbledhurit "kok më kok" i këngëtarëve

Nga Timo Mërkuri*

Kur flasim për këngët labe në tërësi, e Iso-Polifoninë në veçanti, kujto që i ka parë apo dëgjuar goftë dhe njëherë të vetme, menjëherë i vete mendja te një grup i mbledhur kokë më kokë me njeri tjetrin duke kënduar. Ata mund të jenë katër, pesë apo më shumë persona. Njeri mund të jetë marësi, tjetri mund të jetë hedhësi, i treti pritësi ose mbajtësi i isos, kjo s'ka rëndësi. S'ka rëndësi as kënga që këndojnë, këngë dashurie, malli, trimërie apo vaji. Nuk e përbën teksti i këngës portretin. Ajo që të mbetet në mendje është pikërisht ky grumbullim kokë më kokë i njerzve që këndojnë, pavarësisht se kush ja mer e kush ja kthen, apo kush mba iso. Ajo që është karakteristika e këngës polifonike është pikërisht kolektiviteti i grupit që këndon.

Në goftë së marësi ka një privilegj mbi të tjerët, privilegj që buron nga aftësia e tij vokale, është pikërisht fakti që kënga i lejon atij ta nisë i pari atë, këngën duke u bërë kështu një tip lajmëtar, si të thuash të kumtojë para të pranishmëve faktin së këndohet për një person apo ngjarje. Dhe ky ka të drejta shumë të kufizuara, të kumtoje me një varg, e shumta dy vargje atë çka i ngarkon kënga. Sa më e vjetër të jetë teknika e të kënduarit aq më pak vargje kumton marrësi. Le të kujtojmë këngën "Vajzë e valëve", ku marësi këndon vetëm gjysëm vargu; Vajzë e valëve, me një zë që të kujton shkreptimin e vetëtimës. Pas kësaj vjen si bubullimë zëri i grupit në vijim; ...zemëra s'ja mban, për të vazhduar me gjëmime e suferinat e isos. Të njëjtën teknikë ka edhe kënga "Bejkë e bardhë", ku marësi kumton vetëm fillimin; O duke tundur...dhe për tu vazhduar nga grupi...zbrer nga zalli. Rrallë ndodh që marësi të këndojë një strofë të tërë i vetëm. Dhe në goftë se ka raste të tilla, kemi të bëjme me këngë të reja, jo vetëm si tekst, por edhe si substancë kënge, si teknikë. Pasi marësi kumton



çka për të kumtuar, identiteti i tij zhduket, ai përzihet e bëhet një me mbajtësit e isos. Si të thuash kënga se lejon t'i "ngrihet mendja shumë", të dallohet mbi të tjerët dhe ca më pak të ngrihet mbi këngën. Është ajo sovranja e vetme, të tjerët e shumta mund t'i shërbejnë ca më mirë pikërisht asaj, këngës, ashtu si hyjnitë e Olimpikut kishin madhështinë e tyre, por kursesi më të madhe së Kryehyjnia, Zeuzi dhe s'mund të bënin asgjë mbi të.

Po kështu dhe pritësi, ndonëse me më pak "fat" se marësi, pasi ngrihet për një çast mbi të tjerët, befaz binte thjeshtë në anonimatin aty ku ishte grupi me jetëgjatë i këngëtarëve, ai i mbajtësve të iso-s. Themi grupi me jetëgjatë pasi realisht ky grup, jo vetëm nuk ka "pretendime" për tu dalluar, por që kur fillojnë kënga, ose së paku pas vargut të parë, e gjer sa mbaron ajo, ky grup është i "ndezur". Ose e thënë ndryshe kënga fillojnë të fluturojnë në qiellin e tyre, pra të isos. Nuk po përmendim këtu këngë tejet të vjetra të cilat fillojnë me një imitim iso-je, për të vazhduar më pas me tekstin e zakonshëm të këngës të ndërprerë nga iso-ja.

Ajo që duam të theksojmë në këtë shkrim është pikërisht anonimati që marin të gjithë këngëtarët. A e kini vënë re kur flasim për këngët polifonike rrallë themi kënga që ja mori filani e ja ktheu filani, por themi kënga e këtij

grupi, dhe po të kemi njohuri të mëtejshme mund të themi edhe... që ja mori filani. Sepse merita nuk është e marësit, e hedhësit apo e ndokujt tjetër, sado i talentuar që të jetë ai, por e gjithë grupit. Dhe këtij ligji të pashkruar nuk i kanë shpëtuar as korifejtë e iso-polifonisë. P.sh. themi Grupi i Himarës, dhe jo Neço Muko, ose më e shumta mund të dëgjojmë të thuhet Grupi i Neço Mukos nga Himara. Pra e theksojmë sidomos fjalën "Grupi". Dhe në fakt vetëm kështu e konceptojmë këtë këngëtar, në mes të grupit të tij. Dhe kjo jo vetëm që nuk ja ul vlerat këtij vigan, por përkundrazi e bën atë më madhështor pasi dhe në përfytyrimin tonë ai nuk vjen si një vetmitar sado i madh, por e përfytyrojmë të rrethuar nga shokët e grupit të tij famoz.

Kolektiviteti i iso-s dallohet edhe tek vetë natyra e këngës. Përfytyroni pak ju lutem. Një grup këngëtarësh që për ndonjë arsye kanë rënë në heshtje ose janë në një bisedë të ndezur. Vazhdimi i debatit mund të sjellë ndonjë sherr ose keqkuptime të mëtejshme, ose s'ka fare kuptim, ose në rastin e heshtjes, ajo mund të bëhet më e rëndë. Atëherë dikush mer iniciativën e këngës dhe vetëvitet në rolin e marësit. Fillon këngën. Sipas rregullit thotë vargun e parë dhe befaz atmosferën e tensionon thirrja e tij...iso, more djema, ose mbaje. Pikërisht kjo thirje si pa kuptim në kon-

teks s'është gjë tjetër veçse një ftesë për kolektivitet. Për t'i lënë debatet e pakuptimta dhe për t'ju shtruar këngës. Zakonisht nëpër dasma kjo ftesë bëhet dhe me vargje si; Do këndojmë apo çdo bëjmë/ A do ngrihem në këmbë/ Ose me vargjet; Ç'bënetë në shtëpinë tënë/ bytym valle, bytym këngë. Nuk mund të gjendet mënyrë më fine për të tërhequr vëmendjen nga sherrat e zakonshme të dasmave dhe për të të ftuar në këngë, jo si individ, por në kolektivitetin e këngës si pjestar i një kolektiviteti.

Por këtë natyrë kolektiviteti kënga shpesh herë e ka dhe në vetë tekstin e saj si nevojë, si qëllim, si mision. Janë me qindra këngët që bëjnë fjalë për bashkim, ndihmë në luftë, solidaritet etj; Dërgon Gjoleka zhevap/ Vaso Kolagji bajrak/...Na kërkon Shkodra imdat (ndihmë)/Të luftojm me Karadak/Se ja kanë bërë çark.

Kolektivitetin iso-ja e ka kultivuar te njeriu si domosdoshmeri jetike. Pa atë, pra kolektivitetin nuk mund të konceptohet kënga. Por jo vetëm kaq.


Është një fakt; jo të gjithë ne këndojmë këngë polifonike. Jo të gjithëve na është dhënë rasti të këndojmë në grup dhe jo gjithmonë e kemi gati një grup për të kënduar kur duam të këndojmë. Shpesh herë jemi vetëm, diku në rrugë, mal apo thjesht në shtëpi dhe befaz nënvendija jonë ndjen nevojën e këngës, ndjen nevojë të shfryjë një maraz, një dhimbje, një dert a sevda. Mënyra që zgjedh vetdija jonë është thjesht kënga polifonike. Por ja që jemi vetëm. Çuditërisht ky fask s'përbën asnjë pengesë. Dhe ja fillojmë të logatim (kështu quhet të kënduarit vetëm e për vete) këngë të ndryshme. Më të zakonshme janë ato këngë që thërrasin dikë të na vijë pranë, të mos na lëjë vetëm. Ky që thërrasim mund të jetë prindi, shoku, miku apo mikja sipas rastit. Jo rrallë thirret mali apo fusha, një rugë fshati ku kaluam

fëmijërinë a një shteg ku pritëm miken për herë të parë. "O ju male me dëborë, pse s'qani hallet e mia", rënkon poeti popullor dhe se shqetëson fare fakti që i drejtohet jo një njeriu por një sendi, një objekti, një zogu (O ju zogj që veni e vini dua tju pyes) që s'ndjen e s'kupton gjë. Kjo s'ka rëndësi. Rëndësi ka fakti që nuk duam ta pranojmë vetminë, që thërrasim dikë të vijë të qajë hallet me neve, apo të gëzojë me ne. Vetmi të tilla kanë lindur këngët e famëshme të kurbetllinjve e të nizamëve, të vajzave të dashuruara (Në rëzë të Kallamesë/Dola korba të pëjesë/...Në mos ardhte dhe nashtinë/Do mar zjarr do djeg shtëpinë) apo të kaçakëve trima.

Por ajo që ka më shumë rëndësi në këto logatje është fakti që imitohet të kënduarit në grup. Pra personi që këndon vetëm fillimisht imiton marrësin, pastaj hedhësin, etj. gjer te imitimi i mbajtësve të isos. Dhe ju kujtoj që kjo bëhet vetëm nga një njeri. Duket si çmenduri. Ju siguroj që është zgjidhja më e bukur e popullit tonë për të luftuar vetminë e imponuar sipas rastit nga jeta, puna, lufta, etj. Ta parafytyrosh veten në qendër të një grupi arti ku je vetëm. Dhe jo vetëm ta parafytyrosh, por dhe ta vendosësh, ta imponosh veten të vendosësh në qendër të një grupi këngëtarësh, pikërisht aty ku s'ke as grup dhe as këngë kjo është sa madhështore aq dhe shpëtimtare. Dhe ju kujtoj se vetmia është armiku më i madh i njeriut, individualiteti është armiku më i madh i humanizmit. E pra populli ynë e ka patur me tepri humanizmin dhe një nga faktorët kryesorë është dhe kënga në tërësi dhe iso-ja në veçanti (se jo të gjithë dinë të këndojnë solo ose t'ja marin, por më lehtë mësohet që bashkë me të tjerët të mbash iso sepse aty zëri yt s'është thjeshtë yti, është pjesë përbërëse e iso-s, pra s'ke më pronësi e përgjegjësi mbi të e për të).

* Folklorist

VITRINA E LIBRIT POLIFONIK



1. Titulli "Rrëfime të moçme nga Lunxhi". Autor Koço Vasili Red. Th.Dino & O. Çerkezi Sh.b Argjiro, Gjirokastër 2006 Përmbajtja: Rrefenja dhe histori për jetën, këngën, kulturën dhe traditat e Lunxhërisë e lunxhiotëve.



2. Titulli "Hulumtuesi i Bukurisë Shqiptare" Autori Dr. Sali Hidri Redaktor Prof. Dr. Agron Xhagolli

Përmbajtja: Monografi e plotë për veprimtarinë e kulturore, shkencore, hulumtuese, poetike të folkloristit dhe intelektualit të shquar Stavro Thoma Frashëri (1900-1965) SHB Globus R., Tiranë 2005.




3. Titulli "Këllëzi - Legjendë-Këngë-Trimëri"

Autori Prof. Dr. Arqile Bërzholi Përmbajtja: Histori, dokumenta, legjenda, këngë dhe kujtime për traditat, folklorin, historinë e fshatit Këllëz të Lunxhërisë në Gjirokastër. SHB Julvin 2, Tiranë 2006

Nga Matilda Troka*

Çfarë qenka ajo ndjesi shqiptare që të huajt me vend e pa vend, e quajnë ekzotike? Kur francezi Eric Marchand erdhi në Festivalin Folklorik Kombëtar të Beratit, 10 vjet më parë, mendonte se shija për muzikën folk ballkanike, mund ta çonte drejt një zbulimi shqiptar. Dhe ky zbulim ishte grupi polifonik i Mallakastrës me Guri Rrokaj, Vladimir Shehaj, Ali Shametaj dhe Fatmir Tahiraj. Katër burra mbi të tridhjetepesat që këndonin pa instrumente. Marchand, ky perëndimor prej vitësh kishte udhëtuar nëpër botë në vende me traditë folklorike. Kërkues, novator, i hapur ndaj kulturave, muzikës së popujve të tjerë i propozon katërshes nga Mallakastra, të jenë pjesë e grupit të tij eksperimental ndërkombëtar, të këngës polifonike e monodike (a capella). Ansambli i vogël i Mallakastrës u bashkua në Bretaninë, ku ndodhet streha dhe laborator i kërkimit muzikor të Eric Marchand, me pjesën tjetër të trupës që vinin nga vende të ndryshme të botës, dhe të çuditshme.

Ishin "Tenore de Santu Predu" ansambël nga Sardenja, Fransy Gonzalez nga Galicia, Bassey Kone nga Mali (Afrikë) dhe vetë Marchand këngëtar e instrumentist bretanez.



Muzika që vetë Zoti ëndërron

Profili i grupit polifonik të Mallakastrës në një hapësirë folklorike ndërkombëtare

Manaxheri i disa koncerteve për grupin shqiptar, Viktor Sharra, thotë se "Kan" sjell një përvojë të re eksperimentale në muzikën folk. Janë të gjithë këngëtarë tradicionalë që interpretojnë me veshë dhe asnjë prej tyre nuk di të lexojë notat. Puna konsiston në faktin që secili prej tyre zgjedh këngë të vendit që përfaqëson të cilat mund të këndonin bashkë. Dhe nuk ishte e lehtë të gjeje këngë që të plotësonin këtë kusht. E veçantë për katërshen nga Mallakastra, duke qenë këngëtarë lokalë, zërat e tyre hynin në një gamë më të gjerë muzikore, duke u adoptuar më lehtë e më mirë, me ritmet spanjolle, bretone e afrikane.

Koncerti i parë erdhi po vitin e takimit të grupit,



në 2000. Ishte sukcesi në skenën e Teatrit në Bretaninë. Në vitin 2001 realizojnë të parën CD. Kohët e fundit, kanë dhënë koncert në Korsikë, Poitier dhe Perigeux të Bretanjes. Kjo muzikë të cilën media franceze si "Le monde" e "Liberation", e cilëson si "Muzika për të cilën Zoti ëndërron", ende nuk mund të shitet jashtë Francës.

Repertori Edhe "Xhan-xhan, vetullaholla"

Ashtu si pjesëtarët e tjerë të "Kan"-it, edhe shqiptarët në çdo koncert kanë në repertor tre-katër këngë popullore. Ansambli polifonik i mallakastrës, këndon thuj gjithë këngët e Jugut shqiptar, por dinë të jenë të manovrueshëm edhe me trevat e tjera.

Këngët kryesore të cilat janë përfshirë edhe në CD-në e "Kan"-it, regjistruar në vitin 2001, janë shumë të njohura për të gjithë ne: "Legjenda e Ago Ymerit", "Më dërgoi babai me shqerra", "O Margarita, ku je", "Dasma", "Dil Pasha se kam pak punë" dhe shumë e njohura "Xhan-xhan vetullaholla". Në këto polifoni shqiptare përzihen jehonat e isove nga Mali, Sardenja, Bretanja e Galicia. Askujt nuk i vritet veshi, secili të vetën, secili për tjetrin. Interpretohen këngë të origjinave të ndryshme. Maliana Kone këndon në "Dambara" dhe në "Ubobo", sardët dhe galiciani, këndojnë në vetën, Marchand në ritmet bretone dhe shqiptarët këndojnë shqip. Por ndryshe nga të tjerët ata munden të këndojnë ndonjëherë edhe bretonen. Kështu kryqëzohen gjuhët,

dhe qëllimi nuk është që kjo përzierje e formave të pabarabarta polifonike të jenë me çdo kusht në harmoni. "Një temperament shumë larg asaj që e kemi zakon të dëgjojmë nga muzika oksidentale", - do thoshte lideri dhe krijuesi i "Kan", Eric Marchand.

Pelegrini i kulturave

"Të gjithë ne funksionojmë mbi bazë të traditës orale. Për të kuptuar se cili është koncepti i tyre i ritmit, melodisë, modeleve, masës, duhet të hysh seriozisht në mendimin muzikor të njerëzve me të cilët punojmë, për të ditur cilët janë kufijtë, interesat që duhet të ruajë një këngëtar", - shpjegon etnomuzikologu francez Eric Marchand. Ky njeri ka punuar gjatë dhe me kujdes me të zgjedhurit e tij. Ka vizituar dhe udhëtuar nëpër vendet e shtëpitë e tyre dhe ka regjistruar shumë nga repertori i tyre. Në skenë, akoma më shumë në regjistrimin e CD-ve kërkohet që çdo këngëtar të jetë në funksionin muzikal të tjetrit. Ndërsa roli i Marchand-it është që ansambli të japë maksimumin e mundshëm. Duke respektuar identitetet artistike të secilit, bretoni Marchand dhe pelegrinazhi i tij ia ka dalë mbanë: të eksplorojë në takimet mes kulturave të përbashkëta dhe dallimet, duke luajtur mes kufijve të tyre.

* Korespondente e Gazetës "Shqip" në Fier

Këngëtarë që promovohen vlerat historike

Artisti i polifonisë Guri Rrokaj, nga më të njohurit interpretues të polifonisë në gjithë vendin, kësaj herë përkrah me vlerën e polifonisë, ka ditur të rendisë mjaft bukur krahas këngës mallakastriote edhe kontributet e personaliteteve të kësaj treve në të gjitha fushat. Ngjan me një polifoni të vërtetë sistemimi enciklopedik i një materiali të gjerë historik dhe aktual. Autori përpigjet të tregojë edhe një herë vlerat e padiskutueshme të krahinës së Mallakastrës.

Promovimi i këtij libri u organizua oak ditë më parë në mjediset antike të qytetit ilir të Byllysit në prani të folkloristëve, studiuesve, gazetarëve dhe intelektualëve nga Tirana, Ballshi, Fieri, Gjirokastra, Përmeti, Himara, etj

Këngëtarë Guri Rrokaj boton dhe promovon në Byllysit monografinë "Mallakastra"



"Me përkujdesjen e një artisti të vërtetë i cili di të transmetojë mjaft mirë atë çka mbart historikisht krahina e tij, brenda profilit dhe formimit të tij artistik autori Guri Rrokaj ngre në nivelet më të larta të vlerave të krahinës së Mallakastrës me të gjithë përbërësit e saj, që nga shtrir-

ja gjeografike, trashëgimin kulturore si dhe karakteretë të veçantë të natyrës së mallakastriotit", kështu u shpreh në veprimtarinë e promovimit të këtij libri kryetari i qarkut të Gjirokastrës Resul Llogo.

Në zhanrin e një monografie ky libër tregon dhe rendit mjaft bukur të

gjitha pikat arkeologjike të Mallakastrës që cilësohen deri më sot si pika të mirëfillta ilire, larg qëndrave romake apo bizantine që shfaqen dukshëm në vendet tjera arkeologjike shqiptare. Mallakastra - Monografi jep një listë të mirëfilltë të të gjithë heronjëve të saj në vite që nga koha e para Skëndërbeut e deri tek ministrat e deputetët e sotëm të Mallakastrës. Ata që jetojnë në këtë krahinë dinë të dallojnë mjaft qartë dhe ndarjen e saj në të butë dhe në të egër, ndarje e cila lidhet edhe me karakteret e popullit të trevës. Kjo pjesë e librit sa vlerësuese aq edhe egoiste, zë vend të posaçëm në citimin më të fundit shumëfaqësh të monografisë.

Në këtë promovim, krahina e Mallakastrës edhe autori i librit dhe biri i saj Guri Rrokaj që ka marrë titullin "Nderi i qarkut" të Gjirokastrës nga zoti Resul Llogo i përkasin më shumë se kurrë njeri-tjetrit. Dhe mbarë vendit, thotë Afërdita Onuzi, drejtoresh e Institutit të Kulturës Popullore të Shqipërisë e pranishme në promovimin e librit. Ajo ka shprehur konsideratat e saj për vlerat e kësaj krahine dhe të bijëve të saj duke e cilësuar Mallakastrën si një pikë referimi të kulturës dhe qytetimit të kahershëm dhe modern. Ndërkaq edhe studiuesi dhe folkloristi i shquar Ermir Dizdari shpreh konsiderata dhe opinione positive për librin dhe autorin. "Kësisoj

Guri Rrokaj, polifonisti i njohur me një numër të madh trofesh në festivale nga Gjirokastra deri në Bretaninë të Francës dhe Bostonin e largët amerikan, na tregon mjaft bukur familjen e vërtetë mallakastriote, evolumin e saj, herë herë të ngadaltë e herë herë me shpejtësi drejt asaj që mund të quhet piku i qytetimit dhe njëkohësisht vegjetimi i saj.

"Mallakstër ke lisa, ke shmëbinj plot forcë, ke burra, ke djem levend, ke vajza bukuroshe, ke dhën e dhi, me zile e këmborë. O Mallakstra ime... unë ty të falem", kështu është betimi i çdo mallakastrioti, ardhur deri në kohët e sotme me mundime por që tingëllon njësoj si shekuj më parë dhe që bënë popullin e saj më krenarë se kurrë.